

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaFill®

### VESHJE HIDROIZOLUESE ELASTIKE PËR APLIKIM TË MENJËHERSHËM

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Veshje me 1 përbërës, e ngjyrosur, me bazë uji dhe elastike, në formë emulsi, me konsistencë kremoze dhe me bazë kopolimeresh stireni-akriliku. Pas tharjes, formon një membranë hidroizoluese fleksibël dhe me rezistencë afatgjatë.

#### PËRDORIMET

Hidroizolim terracash mbi nënshtresa të ndryshme, si pllakat qeramike, llaçet e përforcuar me fibra, zinku, alumini, druri, tullat, llaçet, betoni, membranat bituminoze me alumin si veshje përfundimtare, etj.

- Mbrojtje e mureve ndarës kundër hyrjes së ujit
- Mure vertikale anësore, tubacione, etj.
- Mbyllje e çarjeve dhe plasaritjeve
- Riparim pllakash dhe ulluqesh prej zinku
- Trajtim i pikave të takimit në oxhaqe

Për aplikim mbi baza PVC ose poliesteri edhe mbi bojë, këshillohet kryerja e testeve të mëparshme për të përcaktuar kompatibilitetin e tyre dhe nëse nevojitet më parë smerilizim.

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I papërshkueshëm ndaj shiut dhe spërkatjeve
- Tepër elastik
- Rezistencë ndaj vjetërimit nga moti
- Aplikim i lehtë me metodën tradicionale të ftohtë
- Depërtim i mirë në plasaritje dhe çarje
- Aftësi për të shoqëruar lëvizjet tkurrëse dhe kontraktuese të bazës pa u plasaritur
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e nënshtresave të zakonshme
- Me bazë uji, jo toksik apo i djegshëm

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Emulsion uxor me kopolimere stireni-akriliku
<b>Ambalazhi</b>	kovë 1kg, 5kg dhe 20 kg
<b>Ngjyra</b>	Emulsion, terracotta, e bardhë, gri
<b>Jetëgjatësia</b>	18 muaj nga data e prodhimit
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe i mbrojtur nga lagështia dhe rrezatimi diellor.
<b>Dendësia</b>	~ 1.28 kg/l
<b>Përmbajtja e substancave të ngurta për ~ 60% peshë</b>	

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	≥120 N/cm <sup>2</sup>	(ASTM D-412, Metoda e testimit A)
Zgjatimi deri në thyerje	~ 450%	(ASTM D-412, Metoda e testimit A)
Vjetrimi artificial	<b>Kushtet</b> 800h, 70°C Testi QUV, 400h	<b>Zgjatimi deri në thyerje (%)</b> 300 200 (ASTM D-412, Metoda e testimit A)
	Humbja e masës: <3% (QUV, 400h)	
Reflektimi i rrezatimit diellor	0.80 (fillestar, ngjyrë e bardhë)	(ASTM C 1549)
Emetimi termik	0.88 (fillestar, ngjyrë e bardhë)	(ASTM E 408, C1371, standarde të tjera)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

#### Për aplikim mbi mure anësorë vertikale:

Shtresë prajmeri: 1 x SikaFill® i holluar (për nënshtresa shumë poroze)  
Veshja: 2 x Sikafill®

#### Për aplikim mbi çati:

Shtresë prajmeri: 1 x SikaFill® i holluar (për nënshtresa shumë poroze)  
Veshja: 2 x SikaFill®

#### Për aplikim mbi çati (sistem me rezistencë mekanike më të lartë)

Shtresë prajmeri: 1 x SikaFill® i holluar (për nënshtresa shumë poroze)  
Veshja: 1 x SikaFill®  
Përforcimi: Sika® FiberNet (e bardhë)  
Veshja: 1 x SikaFill®

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

### Rendimenti

Mbi çati dhe tarraca: 1 kg/m<sup>2</sup> - 2 kg/m<sup>2</sup> në 2 ose më tepër shtresa, në varësi të nënshtresës.

Mbi mure anësorë vertikale: të paktën 1 kg/m<sup>2</sup> aplikuar në 2 veshje.  
Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firon, etj.

### Temperatura e mjedisit

+5°C min. / +35°C max.

### Lagështia relative e ajrit

75% max.

### Temperatura e nënshtresës

+5°C min. / +35°C max.

### Pika e vesës

Kujdes kondensimin!

Nënshtresa dhe membrana e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes mbi membranën.

### Koha e tharjes

I thatë në prekje: ~ 2 orë (në 20°C)

Tharje e plotë: ~ 3-5 orë (në 20°C)

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet e sipërfaqes si boshllëqet dhe vrimat duhet të ekspozohen plotësisht.

Riparoni nënshtresën, duke përdorur llaçet e përshtatshëm Sika® MonoTop® ose SikaRep®. Pluhuri, materialet e lira dhe shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose fshesë thithëse. Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë

dhe pa kontaminues si pislëqe, vaj, graso, veshje, etj. të cilët parandalojnë ndërkapjen e duhur. Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme.

Në rast dyshimi aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

### PËRZIERJA

Përziene SikaFill® (manualisht ose me mikser në shpejtë të ulët) përpara se të përdoret deri sa të jetë plotësisht homogjen.

## APLIKIMI

Aplikimi mund të bëhet me rul leshi me qime të shkurtëra, furçë ose pistoletë pa ajër. Me rul ose me furçë, aplikoni një shtresë produkti të holluar në raportin 25% me ujë, duke synuar depërtimin e tij në çarje dhe plasaritje. Sapo shtresa e prajmerit është tharë, vazhdoni me shtresat vijuese të SikaFill® derisa të përftohet trashësia e dëshiruar e cipës. Përpara aplikimit të një shtrese, shtresa e mëparshme duhet të jetë tharë plotësisht. Në varësi të përdorimit dhe në rast se do të nevojitet përforsim, Sika® FiberNet do të vendoset mbi shtresën e parë dhe ende të freskët të SikaFill® të pa holluar, duke e mbuluar me një shtresë të dytë SikaFill® të pa holluar. Bashkimi i Sika®FiberNet duhet bërë duke e mbivendosur nga ana e gjerësisë 3 deri në 5 cm.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Produkti formon një shtresë përfundimtare. Çrregullimet mbi sipërfaqe dhe zona me ujë të mbledhur pellg duhet të riparohen me llaçe të përshtatshëm për meremetime përpara aplikimit të SikaFill®.
- SikaFill® nuk rekomandohet për kontakt të përhershëm me ujin.
- SikaFill® nuk rekomandohet për qëndrim të përhershëm nën ujë.
- Aplikoni gjithmonë 2 veshje prajmeri mbi nënshtresat me porozitet të lartë.
- Në rast se do të kërkohet membranë me rezistencë mekanike më të lartë, vendosni Sika® FiberNet (e bardhë) tek sistemi ose çdo sistem tjetër përforsues kompatibël me SikaFill®.
- Në zona të vizitueshme dhe me trafik të shpeshtë, këshillohet aplikimi i një shtrese përfundimtare të Sikagard®-550 W Elastic si mbrojtje.
- Mos vendosni objekte shpuese mbi trajtimin.
- Për të përfutuar ndërkapje mbi membranat bituminoze me cipë polietileni kundër ngjitjes, do të duhet të digjen përpara aplikimit të SikaFill®.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
SikaFill®  
Shkurt 2019, Botimi 01.01  
020915101000000001

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaFill-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf



BUILDING TRUST